



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:155513

Datë: 24.04.2024

Numri i dokumentit: 05614023

PPP.nr.176/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i përgjithshëm, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit T.K. Sh.A, me seli në Prishtinë, kundër debitorit A.S. nga fsh ..., Komuna e Ferizajt, për pagesën e borxhit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 24.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “A.S.”, i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.235/2019, të datës 06.09.2019, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat Sh.L. nga Ferizaj, dhe **MBETET NË FUQI** urdhri mbi lejimin e përmbartimit P.nr.235/22, i datës 06.09.2019.

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.235/2019, të datës 06.09.2019, Përmbartuesi privat Sh.L., e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga kreditori T.K. SH.A, kundër debitorit A.S., për pagesën e borxhit në shumë prej 160 euro, në bazë të faturës Nr....., të datës 04.07.2019, si dhe pagesën e shpenzimeve të përmbartimit, ose bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorit si dhe regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit dhe nga shuma e fituar nga shitja e sendeve të debitorit të paguhet borxhi i kërkuar nga kreditori.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, me të cilin i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta shfuqizoj urdhrin për përmbarim.

Kreditori në përgjigjen e ushtruar me shkrim në prapësimin e debitorit, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarim dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi në fjalë është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Gjykata vlerëson se urdhri për përmbarim i lëshuar nga Përmbaruesi privat Sh.L., me numër P.nr.235/2019, i datës 06.09.2019, është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore, ngase përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori në bazë të nenit 29, par 1, nën par 1.2, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se pas skadimit të afatit të kontratës kam qenë në njërin nga pikat e valas për ndërprerjen e kontratës disa herë por ata në moskomunikim me mua kanë vazhduar të më llogarisin pagesat edhe pas përfundimit të kontratës, e që numrin nuk e kam shfrytëzuar si dhe e kam të deaktivizuar dhe pas aktivizimit prap se prap ata kanë vazhduar të më llogarisin pagesat mujore, Gjykata këto pretendime i konsideron të pabazuara sepse nga prapësimi i debitorit, shihet se i njëjti prapësimi nuk i ka bashkangjitur asnjë provë të vetme me shkrim në bazë të cilës do të vërtetohej pretendimi i tij në prapësim. Për më tepër, në nenin 69, par 4, të LPP-së, është paraparë shprehimisht se: *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet.”*. Po ashtu, në paragrafin 5, të nenit 69, të LPP-së, është paraparë shprehimisht se: *“Prapësimi kundër vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues mund të paraqitet ekskluzivisht sipas dispozitave të nenit 71, të këtij ligji”*, dhe nga prapësimi i debitorit, Gjykata ka konstatuar se asnjëri nga pretendimet e debitorit nuk janë pretendime që bëjnë pjesë në grupin e shkaqeve të prapësimin nga neni 71, par 1, të LPP-së.

Po ashtu, Gjykata konstatoj se në këtë rast, me nxjerrjen e urdhrin për përmbarim P.nr.235/2019, të datës 06.09.2019, Përmbaruesi privat Sh.L. ka vepruar në pajtim me nenin 29, par 3, dhe nenit 38, par 1, të LPP-së, sepse siç konstatohet nga shkresat e lëndës, propozimi për përmbarim i kreditorit në këtë rast e përmban dokumentin e besueshëm në origjinal, kërkuesin e përmbarimit dhe debitorin, adresën e vendbanimit dhe të selisë së palëve, kredinë

që kërkohet të realizohet, si dhe mjetin nëpërmjet të cilit duhet kryer përmbarimi, si dhe të dhënat tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit. Po ashtu, fatura në bazë të cilës është nxjerrë urdhri i atakuar, është në tërësi e përshtatshme për përmbarim, për arsye se siç shihet në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar. Përveç tjerash, Gjykata konstatoj se në këtë rast janë plotëuar edhe kushtet ligjore të parapara në nenin 30, të LPP-së, ku në faturën në bazë të cilës është nxjerrë urdhri për përmbarim i atakuar me prapësim, nga kreditori është shënuar edhe afatit i përmbushjes së detyrimit, respektivisht afati i pagesës deri më datën 23.07.2019.

Andaj, Gjykata duke i marr parasysh thëniet e debitorit në prapësim, përgjigjen me shkrim të kreditorit në prapësimin e debitorit, provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe vendosi që të njëjtin ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar ndërsa urdhri për përmbarim P.nr.235/2019, i datës 06.09.2019, të mbetet në fuqi.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.176/22, më datë 24.04.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.